



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

**VENDIM**

Nr. 60, datë 30.06.2020

**PËR  
MIRATIMIN E PAKËSIMIT TË TË ARDHURAVE TË VITIT 2020 TË BASHKISË  
DURRËS NË SHUMËN 750,000 LEKË DHE KTHIMI I KËSAJ SHUME  
ORGANIZATËS JOFITIMPRURËSE “WORLD VISION ALBANIA”**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr.88, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Marrëveshjes së bashkëpunimit Nr.10264 Prot., datë 29.05.2019 “Rikonstruksion dhe vënia në funksion e sistemit të ngrohjes (kaldajat) të shkollave, “Neim Babameto”, “Shkolla e Re”, “Stacioni Zooteknik” nënshkruar midis Bashkisë Durrës dhe Organizatës Jofitimprurëse World Vision Albania si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Arsim, Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Komuniteteve Fetare dhe Sektori i Projektimit, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,


**KËSHILLI BASHKIAK  
V E N D O S I :**

1. Miratimin e pakësimit të të ardhurave të vitit 2020 të Bashkisë Durrës në shumën 750,000 (shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.
2. Miratimin e kthimit të shumës 750,000 (shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, Organizatës Jofitimprurëse “WORLD VISION ALBANIA”.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit në Bashkinë Durrës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

Ani Dyrmishi



**U shpall sot me datë 01.07.2020**



6052/2

2


REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 586/prot.  
4.



Durrës, më 06.07.2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS ✓

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.60 datë 30.06.2020 Për miratimin e pakësimit të të ardhurave të vitit 2020 të bashkisë Durrës në shumën 750,000 lekë dhe kthimi i kësaj shume organizatës jofitimprurëse “WORLD VISION ALBANIA”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

